



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Vitina

10.02.2020  
02-035/02-122

Në bazë të nenit 13, të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ( Gazeta Zyrtare e Republikës ), nr,28/15 qershor 2008) ,neni 44 të Ligjit, nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 17, parag.2 dhe neni 18 parag.1.5 të Ligjit nr.04/L-060, për mbeturina , Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

## U R D H Ë R E S Ë

### Për subjektet afarist dhe ndërmarrjet tjera shërbyese si dhe prodhuesit e mbeturinave komunale (amvisëritë) për menaxhimin e mbeturinave

1. Urdhërohen të gjithë subjektet afarist dhe ndërmarrjet tjera shërbyese si dhe prodhuesit e mbeturinat komunale (amvisëritë) që janë prodhues të mbeturinave dhe inportues të mallrave me potencial për krijimin e mbeturinave t'i menaxhojnë mbeturinat e krijuar nga produktet e tyre;
2. Të gjitha subjektet afariste dhe ndërmarrjet tjera shërbyese si dhe prodhuesit e mbeturinat komunale (amvisëritë) duhet t'i dorëzojnë mbeturinat kompanisë të licencuar për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave;
3. Për shërbimet nga pika 2 (dy) e kësaj urdhërese , subjektet afarist dhe ndërmarrjet tjera shërbyese, si dhe prodhuesit e mbeturinat komunale (amvisëritë) duhet që deri me dt.01.04.2020, ta rregullojnë këtë çështje me kompanin e licencuar;
4. Ndaj subjekteve afariste dhe prodhueseve të mbeturinave komunale (amvisëritë) që veprojnë në kundërshtim me dispozitave e kësaj urdhërese , do të merren masa konform dispozitave ligjore në fuqi;
5. Për zbatimin e kësaj urdhërese përgjegjese është Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Kompania për menaxhimin e mbeturinave " Eco-Higjena" dhe Drejtoria e Inspeksionit.

#### Urdhëresa i dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. DSHPE-së, D. Inspeksionit dhe KMM-së " Eco-Higjena";
3. Arhivës komunale.

Viti, me dt.07.02.2020

